



Duke u mbështetur në nenin 73 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, nenit 4, 5 dhe 7 deri 10 të Udhëzimit Administrativ, nr. 01/2016, nenit 28 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 3,4,5 dhe 6 të Rregullores për Komitete Konsultative të Komunës së Klinës si dhe vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.06-631/2018 të dt.06.02, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-te të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën 27.04.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për

Vazhdim të Konkursit publik për zgjedhjen e anëtarëve në Komitete Konsultative në Komunën e Klinës

I

Miratohet Vendimi për vazhdim të Konkursit publik për zgjedhjen e Komiteteve Konsultative në Komunën e Klinës në kohëzgjatje prej 7 ditësh.

II

Konkursi si në pikën 1 të këtij Vendimi vazhdohet për dy Komitete Konsultative për shkak të numrit të pamjaftueshëm të aplikanteve.

1. Komitetin për Çështje Emergjente dhe
2. Komitetin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtje të Mjedisit.

III

Kushtet, kriteret, mandati dhe afati për anëtarësim dhe procedura e konkurrimit dhe punës së Panelit intervistues parashihen në konkurs konform dispozitave ligjore në fuqi dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL), Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

IV

Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit për Shpallje të Konkursit publik për zgjedhjen e anëtarëve në Komitetet Konsultative në Komunën e Klinës dhe themelimi i Panelit intervistues për përzgjedhjen e anëtarëve të këtyre dy komiteteve 01Nr.06-631/2018 të dt.06.02.2018 dhe vazhdim i Konkursit të shpallur në gazetën Epoka e Re me dt.06.04 . 2018.

V

Pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal të Klinës, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin Mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-3260 2018
Klinë, më dt. 09.05 2018

